

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Dizajner Grafik

❖ DETYRAT KRYESORE

- Zhvillon dhe zbaton planet periodike të punëve të lidhura me rolin (ditore, javor, tre-mujor e vjetor) në kuadrin e planit të përgjithshëm të detyrave të departamentit të marketingut & PR.
- Propozon modelet krijuese të dizajnit (text, imazh, brandim, faqosje) për çdo kërkesë të paraqitur sipas nevojave të kompanisë.
- Krijim, zhvillim dhe përpunim cilësor të përmbajtjes grafike për materialet e nevojshme (print) për publikime të ndryshme.
- Krijim, zhvillim dhe përpunim cilësor të grafikave statike ose dinamike (digjitale), fotografi (2D), animime (3D) si dhe realizime të videoeve sipas nevojave;
- Përdorim dhe menaxhim i mjeteve, pajisjeve të nevojshme për realizimin cilësor të punës në këtë rol;
- Përdorim i software-ve, përfshirë paketën 'office', paketën adobe (photoshop, illustrator, premier, lightroom, indesign), aftereffects, HTML, etj.
- Ushtrim i iniciatives për të propozuar krijime të përmbajtjeve promovionale, sipas kërkesës.
- Bashkëpunim me pjesëtarët e tjerë në skuadër për përmbylljen cilësore të punëve në grup, sikurse edhe ndërveprim me kolegë nga sektorë të tjerë të kompanisë.
- Bashkëpunim me palët të treta për përmbushjen cilësore të detyrave në realizimin e projekteve në ngarkim.
- Kryen raportimet periodike për punët e kryera sipas kërkesës.
- Mbulon detyra shtesë në skuadër në rast nevojë.

❖ KRITERET KRYESORE

- Nismëtar/e për të nisur procese të reja;
- Vëmendje të përkushtuar ndaj detajeve;
- Aftësi për të menaxhuar kohën në një ambient dinamik pune;
- Aftësi të shkëlqyera dhe eksperiencë në dizejnim grafik;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi;
- Aftësi të mira për të punuar e komunikuar në grup;
- Përqasje për të mësuar e zhvilluar kapacitetet profesionale;

- Diplomë universitare në art&dizajn, dizajn-grafik ose kualifikime e specializime pasuniversitare në degët e mësipërme;
- Eksperiencë e aftësi të mira në punën në grup.
- Të njohë mirë gjuhën angleze

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose info@gener2.al

Afati i fundit i aplikimit eshte data **30 Shtator 2022, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”.